

RAST STUDIMOR

PROCEDURA E PROKURIMIT PUBLIK
MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
“BLERJE DHE SHPËRNDARJE E UNIFORMAVE DHE
KËPUCËVE TË POLICISË SË SHTETIT”

ALBANIAN INSTITUTE OF SCIENCE AIS

Tiranë - Shqipëri

PARASHTRIM

Objekti i këtij Rasti Studimor është procedura e prokurimit me objekt: “*Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit*”.

Ky Rast Studimor, është realizuar si pjesë e aktiviteteve të projektit me titull “*Improvement of Integrity of the Public Contractor. Legislation; Practice and Role of civic Actor*”. Një komponent i projektit është edhe fuqizimi i medias investigative dhe aktorëve civil, që monitorojnë procese të kontraktimit publik me fokus çështje që lidhen me integritetin e kontraktorëve privat.

Qëllimi i realizimit të këtij Rasti Studimor është verifikimi i zbatimit të procedurave ligjore nga Autoriteti i ngarkuar për të zhvilluar procedurën e prokurimit në: hartimin e dokumentave standarde të tenderit, përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues të procedurës.

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij Rasti Studimor konsiston në analizën e detajuar të elementëve të procedurës mbi veprimet e Autoritetit të ngarkuar për të zhvilluar procedurën e prokurimit si më poshtë:

- 1) Identifikimin e procedurës së prokurimit;
- 2) Përzgjedhjen e Llojit të Procedurës së Prokurimit;
- 3) Përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes së operatorik ekonomik fitues;
- 4) Hartimin e dokumentave standarde të tenderit, përfshirë hartimin e termave të referencës dhe kritereve të veçanta të kualifikimit;
- 5) Përzgjedhjen e ofertuesve që kanë shprehur interes për të marrë pjesë në garë, kualifikimin e tyre dhe dërgimin e ftesës për të paraqitur ofertë;
- 6) Kronologjia e Veprimeve të Autoritetit Kontraktor;

Për efekt shkurtimi, Terminologjia e mëposhtme do të citohet me inicialet:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara/Autoriteti zhvillues i Procedurës së Prokurimit – ABP/AZHPP;
Autoriteti Kontraktor – AK ;
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – DPPSH ;
Agjencia e Prokurimit Publik – APP ;
Komisioni i Prokurimit Publik – KPP ;
Ligji nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” – LPP ;
VKM nr. 914 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” – RrPP;
Dokumenta standarde të tenderit – DST ;
Kushte të Veçanta të Kualifikimit – KVK ;
Kriteret e Përzgjedhjes së Fituesit – KPF;
Operator Ekonomik – OE ;
Bashkim i Operatorëve Ekonomikë - BOE
Procedurë e Kufizuar – PK;
Marrëveshje Kuadër – MK;

1) IDENTIFIKIMI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Paraprakisht, vlen të sqarojmë faktin se Autoriteti Kontraktor që do të përfitojë mallin objekt kontrate është **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, ndërkohë që Autoriteti që zhvillon këtë procedurë prokurimi është Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Kjo Agjenci, është krijuar me VKM nr. 81 datë 14.02.2018 dhe organizohet e funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë të Brendshme. Me VKM nr. 82 datë 14.02.2018 kjo Agjenci është ngarkuar nga Këshilli i Ministrave për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e disa kategorive të mallrave dhe shërbimeve, ku në pikën 1.6 të nenit 1 listohet malli: *“Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre” i cili*, referuar sa mësipër prokurohet nga kjo Agjenci për llogari të Autoritetit Kontraktor DPPSH.

Referuar njoftimit të Kontratës, të publikuar në faqen elektronike të prokurimit publik www.app.gov.al, rezultojnë të dhënat e mëposhtme të procedurës së prokurimit:

1. Autoriteti që zhvillon procedurën e prokurimit – Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.;
2. Lloji i procedurës së prokurimit : “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” - Prokurim Elektronik, nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjeve kuadër 4 (katër) vite.
3. Numri i referencës së procedurës: REF-31606-07-25-2019
4. Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”.
5. Fondi limit: 2.800.347.570 (dymiliard e tetëqindmilion e treqinddetyzetëeshtatëmijë e pesëqindeshtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH).
- 5.1 Shumatorja e çmimeve për njësi është: 21.982.366 (njëzetënjëmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë (pa TVSH), ku përfshihet:
 - Shumatorja e çmimeve për njësi të artikujve të veshjeve dhe këpucëve është: 488.141 (katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e njëqind e dyzetë e një) Lekë (pa TVSH)dhe
 - Shumatorja e çmimeve për njësi të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve është: 21.494.225 (njëzetënjëmilion e katërqindnëntëdhjetë e katërmijë e dyqindnjëzetëepesë) Lekë (pa TVSH).
6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Brenda datës 1 Prill për artikujt e uniformës verore dhe brenda datës 1 Shtator për artikujt e uniformës dimërore. Përjashtimisht, afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruhet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë nga lidhja e kontratës së parë.
7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Data: 19/08/2019, Ora: 10:00; në www.app.gov.al.

8. Afati kohor për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje: Data: 19/08/2019, Ora: 10:00; në www.app.gov.al, në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë.

Në datë 15.10.2019 ABP ka publikuar Shtojcën 1, me anën e së cilës ka kryer më shumë se 20 ndryshime në dokumentat e tenderit përfshirë kriteret e kualifikimit, shtojcat e ndryshme të DST-ve, specififikimet teknike, si dhe çmimin për njësi të artikujve objekt kontrate. Gjithashtu, ABP ka njoftuar se Faza e I-rë e Procedurës së Prokurimit - dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrje, është shtyrë për në datë 05.11.2019.

Po në datë 15.10.2019 ABP ka publikuar dokumentin Sqarime nr. 1, nëpërmjet të cilit ka sqaruar se: *“Për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, ku kombinohen disa detyra, është e domosdoshme që mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga 1 (një) ofertues, i cili mund të jetë i organizuar në formën e lejuar nga ligji dhe dokumentat e tenderit, si bashkim i 2 ose më shumë operatorëve ekonomik apo nëpërmjet nënkontraktimit të lejuar deri në 40% të vlerës së mallrave dhe shërbimeve që kërkohen të prokurohen”.*

Për këtë procedurë prokurimi, ka patur një ankesë nga OE “Marsi & AL” sh.p.k., me objekt modifikimin e DST-ve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, ankesë e cila është depozituar edhe në KPP. Me vendimin nr. 790/2019 datë 19.12.2019, KPP e ka refuzuar ankesën e paraqitur nga ky OE, pa e shqyrtuar në themel atë, por ka vlerësuar se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

Me njoftimin e datës 24.12.2019, ABP ka njoftuar në sistemin elektronik se Faza e I-rë e Procedurës së Prokurimit - dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrje është shtyrë për në datë 10.01.2020.

Opinion i ekspertit mbi veprimet e ABP-së për Njoftimin e Kontratës.

* Së pari, nga verifikimi i Njoftimit të Kontratës dhe DST-ve, konstatohet se nga ABP është vendosur në mënyrë të pazakontë dhe të panatyrshme të prokurohen në të njëjtën procedurë (pra me 1 LOT të vetëm) mallra, të cilat pavarësisht se janë të lidhur (sistemi elektronik i shpërndarjes kushtëzohet nga realizimi me sukses i blerjes së uniformave dhe këpucëve) me njëri-tjetrin, nuk kanë elementë të përbashkët në kuptim të eksperiencës së mëparshme, kualifikimeve teknike apo çertifikimeve lidhur me vlerësimin e operatorëve që do të marrin pjesë në garë tjetrin dhe konkretisht: a) Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit dhe b) sistemi elektronik i shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve.

Ky fakt, mund të krijojë konfuzion, stepje dhe kufizim për pjesëmarrje në garë, dhe kushtëzim të operatorëve ekonomikë të specializuar për uniforma dhe këpucë.

*Së dyti, referuar DST-ve të publikuara nga ABP, si dhe referuar modifikimeve të kryera në DST, ndër të tjera rezultojnë të jetë ndryshuar çmimi për njësi i artikujve objekt kontrate (ndryshimet e publikuata në Shtojcën nr. 1) dhe konkretisht: Në njoftimin fillestar të kontratës përcaktohet se: *shumatorja e cmimeve për njësi të artikujve të veshjeve dhe këpucëve është: 488.141 Lekë (pa TVSH) dhe shumatorja e cmimeve për njësi të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve është: 21.494.225 Lekë (pa TVSH).*

Në ndryshimin e publikuar në Shtojcën nr. 1 nga ABP është përcaktuar se, *shumatorja e cmimeve për njësi është: 621.011 Lekë (pa TVSH).*

Siç evidentohet sa mësipër, rezultojnë se është rritur fondi limit për objektin kryesor të procedurës së prokurimit nga 488.141 lekë pa tvsh në 621.011 lekë pa tvsh, pra shumatorja e çmimit/njësi për

mallrat objekt kontrate ka pësuar një rritje prej 30% pa paraqitur asnjë argument apo justifikim ligjor e financiar. Nga ana tjetër është hequr vlera për sistemin elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve, duke e ngarkuar si detyrim të operatorëve ekonomikë ofertues për ta ngritur dhe implementuar “pa shpërblim” këtë sistem.

*Së treti, referuar sqarimit nr. 1 të publikuar nga ABP, nëpërmjet të cilit është argumentuar mosndarja me LOTE e kontratës për shkak të karakterit të ndërlikuar të saj, OE ekonomikë, janë sqaruar se mund të ofertojnë si bashkime të dy ose më shumë shoqërisht. Ky fakt, nga njëra anë nxjerr në pah shkallën e vështirësisë së pjesëmarrjes si operator i vetëm në garë, (pranuar nga vetë Autoriteti) e nga ana tjetër në mënyrë të gabuar ABP ka “orientuar” OE për grupime në bashkime shoqërisht, ndërkohë që pjesëmarrja në një bashkim të dy ose më shumë OE është një veprim që nuk duhet të jetë as i vesuar dhe as i kushtëzuar nga AK, pasi ndikon drejtpërdrejt në uljen e konkurrencës.

RrPP, kanë parashikime të qarta lidhur me “Prokurimin e Përqendruar dhe delegimin e prokurimit”, si dhe Prokurimin e Marrëveshjes Kuadër dhe konkretisht në nenet 2, 45 dhe 45/1 të RrPP miratuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 parashikohet se:

Neni 2

“5. Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet. Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënave sasiore, sipas fondit përkatës. 6. Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t’i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit”.

Neni 45 “Prokurimi i marrëveshjes kuadër”

“1. Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence ose me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Në kontratat sektorale autoritetet kontraktore mund të përdorin gjithashtu procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. 2. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. 3. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla”.

Neni 45/1 “Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër”

“1. Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër. 2. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t’u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër”.

Referuar konstatimeve dhe bazës ligjore të sipërcituar, vlerësoj se shpallja e procedurës së prokurimit e më pas kryerja e mbi 20 modifikimeve përfshirë edhe çmimin/njësi përbëjnë një prove të fortë në argumentin se ABP ka patur nevojë për më shumë qartësi, informacion dhe njohuri në fushën specifike, përpara publikimit të kësaj procedure.

2) PËRZGJEDHJA E LLOJIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Nga verifikimi i të dhënave të publikuara nga autoriteti zhvillues i procedurës rezulton se:

- a) Lloji i Procedurës së përzgjedhur nga ABP është Procedurë e Kufizuar;
- b) Pas kryerjes së Procedurës së Kufizuar, do të nënshkruhet një Marrëveshje Kuadër, ndërmjet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara dhe operatorit ekonomik që do të shpallet fitues.

a. Lloji i Procedurës

Autoriteti zhvillues i procedurës ka përzgjedhur Procedurën e Kufizuar për të realizuar prokurimin e këtij malli. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të publikuara në sistemin elektronik rezulton se në dokumentin e publikuar Sqarime nr. 1, arsytet e përzgjedhjes së kësaj procedure janë:

“Procedura e kufizuar (me 2 faza) është përdorur për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, të cilat mund të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga operatorë ekonomikë, të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional dhe financiar, si dhe duke qenë se është ekonomishtë më e leverdisshme, që fillimisht të shqyrtohen kapaciteti dhe kualifikimet e operatorëve ekonomikë të interesuar (faza e parë) dhe më pas të ftohen të paraqesin ofertat teknike dhe ekonomike, ata që kanë kualifikimet minimale të caktuara (faza e dytë). Të dy fazat e kësaj procedure zhvillohen në rrugë elektronike nëpërmjet platformës së prokurimit elektronik (përveç kampioneve/mostrave të mallrave që dorëzohen fizikisht ditën e hapjes së ofertave në fazën e dytë). Ndarja në dy faza paraqet kosto më të ulëta ekonomike për operatorët ekonomik të interesuar, të cilët nuk janë të detyruar të përgatisin ofertat ekonomike dhe teknike që në fazën e parë (psh. kampione/mostra të mallrave), si dhe kosto më të ulëta administrative për organin qendror blerës. Në përzgjedhjen e kësaj procedure janë mbajtur parasysh aspektet për rëndësinë dhe natyrën e objektit të prokurimit, që përfshijnë kombinimin i disa detyrave deri në marrjen e produktit përfundimtar. Gjendja e tregut vendas dhe atij të huaj e mundëson pjesëmarrjen në fazën e parë të parakualifikimit, të më shumë se dy operatorëve ekonomik që mund të realizojnë objektin e prokurimit, të cilët mund të marrin pjesë edhe si bashkim operatorësh ekonomik. Mallrat dhe shërbimet në lidhje me to, nuk gjenden lehtësisht në treg dhe kanë specifikime teknike e standarde të vecanta, të cilat janë të miratuara me akt nënligjor”.

b. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet ABP dhe operatorit ekonomik që do të shpallet fitues.

AZHPP ka përcaktuar në dokumentat e tenderit se:

“Nisur nga natyra e këtij objekti prokurimi, për të cilin është e pamundur të parashikohen me saktësi sasi të mallrave, sipas masave konkrete të punonjësve të policisë, që do të jenë të nevojshme për furnizim, për një periudhë të paktën 4 vite.

Për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, ku kombinohen disa detyra - nga evidentimi i përmasave trupore të punonjësve të policisë, ngritja e sistemit elektronik të porositjes dhe shpërndarjes së mallrave, pajisja e punonjësve të Policisë së Shtetit me karta me pikë, prodhimi/konfeksionimi i mallrave, deri në marrjen e produktit përfundimtar nga punonjësi i policisë - është e domosdoshme që mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga 1(një) operator ekonomik.

Për shkak të plotësisht të nevojës së autoritetit kontraktor DPPSH, me një lloj veshje uniform, të njëjtë nga koka te këmbët për të gjithë punonjësit e policisë (uniforma dhe këpucë), ku modeli i

përcaktuar, materialet e përdorura, cilësia në prodhim, tonacioni i ngjyrave, nuk duhet të ndryshojnë jo vetëm brenda një uniforme të një punonjësi por as edhe ndërmjet punonjësve me njëri-tjetrin, pra nga prodhimi i lëndës së parë, prodhimi i fijeve dhe kopsave e deri te ndërtimi i saj, duhet të realizohet në mënyrë uniforme. Pra, nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me uniforma vetëm nga një operator ekonomik, i cili duhet të realizojë edhe porositjen e shpërndarjen nëpërmjet sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, tek të gjithë punonjësit e policisë së shtetit në të gjithë vendin, si dhe pajisjen e tyre me karta, me të njëjtat standarde, për një periudhë të paktën 4 vite. Për gjithë sa më sipër, në zbatim të pikës 1/a) të Nenit 47 (Llojet e marrëveshjes kuadër) të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik” (i ndryshuar) do të përdoret marrëveshja kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”. Marrëveshja Kuadër do të lidhet nga Organi Qendror Blerës ABP, në emër e për llogari të autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Opinion i ekspertit mbi veprimet e ABP-së për përzgjedhjen e procedurës së kufizuar dhe zbatimin e kriterëve për Marrëveshjen Kuadër:

1) Në nenin 31 “Procedura e kufizuar” të Ligjit nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Procedura e kufizuar përdoret nga autoriteti kontraktor për të kryer një prokurim që çon në dhënien e ndonjë kontrate publike, kur:

a) malli, shërbimi ose puna përkatëse, për shkak të karakterit të tij/tyre shumë të ndërlikuar ose të veçantë, mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga operatorë ekonomikë, të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar;

b) është ekonomikisht më e leverdishme për autoritetin kontraktues, fillimisht, të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e operatorëve të interesuar ekonomikë dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat”.

Nga mënyra e e ndërtimit të normës ligjore, rezulton se kemi dy kushtet ligjore kumulative. Në vijim, në nenin 34 të VKM nr. 914 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se “1. Procedura e kufizuar është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 31 të LPP-së. 2. Autoriteti kontraktor në përzgjedhjen e kësaj procedure duhet të mbajë parasysh: a) aspektet për natyrën e kontratës; b) afatet; c) kostot përkatëse në zbatimin e procedurës, të ndarë në dy faza; ç) gjendjen e tregut; d) numrin e pritshëm të ofertuesve. 3. Në asnjë rast, vlera dhe përmasat e një kontrate nuk mund të jenë arsyeja e vetme për të justifikuar kompleksitetin e kontratës ose përzgjedhjen e procedurës së prokurimit. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për punë/mallra/shërbime, që gjenden lehtësisht në treg ose që kanë specifikime teknike apo standarde të përgjithshme e të mirënjohura në treg”.

Referuar arsyetimit/sqarimit të publikuar nga autoriteti kontraktor për përdorimin e procedurës së kufizuar, në raport me parashikimet e mësipërme ligjore, konstatojmë se: Përzgjedhja e Procedurës së Kufizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, nuk mbështetet në përcaktimet e Ligjit dhe Rregullave të Prokurimit Publik.

Nuk janë paraqitur prova apo evidenca statistikore e kërkimore për të argumentuar se malli objekt kontrate ka një natyrë komplekse;

Nuk është realizuar një studim i plotë tregu për të përlllogaritur saktë fondin limit/shumatoren e çmimit/njësi, si dhe për të përcaktuar leverdishmërinë e përdorimit të kësaj procedure në raport me përdorimin e Procedurës Klasike dhe të preferuar të Prokurimit Publik siç është Procedura e Hapur;

Nuk është dhënë asnjë argument ligjor apo teknik, për përfitimin që do të ketë ABP nga përzgjedhja e kësaj procedure, lidhur me afatin zhvillimit të saj. Për më tepër, fakti që në muajin Mars 2020 pra më shumë se 8 muaj më vonë nga data e publikimit të Procedurës së Kufizuar, jemi ende në Fazën e I-rë, përbën një tregues që shkon në të kundërt të arsyetimit të përzgjedhjes së saj.

Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësoj se Procedura e Kufizuar e Përzgjedhur nga ABP nuk plotëson asnjë nga kushtet ligjore dhe përcaktimet e rregullave të Prokurimit Publik.

2) Lidhur me zbatimin e kriterëve nga ABP për Marrëveshjen Kuadër, vlen i njëjti përfundim/opinion i trajtuar në pikën 2 më sipër, pra:

ABP ka patur nevojë për më shumë qartësi, informacion të detajuar mbi artikujt, vlerën dhe karakteristikat teknike të artikujve objekt kontrate, si dhe njohuri në fushën specifike, përpara publikimit të kësaj procedure.

3) PËRCAKTIMI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË OPERATORIK EKONOMIK FITUES;

Nga verifikimi i DST-ve të publikuara nga AZHPP rezulton se në pikën 4.2 është përcaktuar se Kriteri i përzgjedhjes së fituesit do të jetë oferta ekonomikisht më e favorshme.

Metodologjia e vlerësimit të ofertave pasqyrohet në Tabelën më poshtë:

Shtohet: Tabela përmbledhëse e kriterëve të peshuara me pikë.

Nr.	Kriteret e peshuara	Pikët
I.	Oferta Ekonomike	0 - 50 pikë
II.	Oferta Teknike	0 - 50 pikë
II.1	<i>Kapacitete teknike:</i>	<i>0 - 20 pikë</i>
a.	<i>Vlera e furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve të të njëjtës natyrë</i>	<i>0 - 15 pikë</i>
b.	<i>Vlera e furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e këpucëve të të njëjtës natyrë</i>	<i>0 - 5 pikë</i>
II.2	<i>Kapacitete njerëzore:</i>	<i>0 - 15 pikë</i>
a.	<i>Numri i fuqisë punëtore</i>	<i>0 - 5 pikë</i>
b.	<i>Certifikatat e stafit teknik të sistemit elektronik të shpërndarjes</i>	<i>0 - 5 pikë</i>
c.	<i>Kualifikimet e stafit teknik për prodhimin dhe shpërndarjen e uniformës</i>	<i>0 - 5 pikë</i>
II.3	<i>Certifikime të ofertuesit:</i>	<i>0 - 5 pikë</i>
a.	<i>Certifikimi ISO 22301</i>	<i>0 - 2.5 pikë</i>
b.	<i>Certifikimi ISO 27001</i>	<i>0 - 2.5 pikë</i>

II.4	Certifikime të mallrave:	0 - 10 pikë
a.	Certifikimi OEKO-TEX tekstile	0 - 5 pikë
b.	Certifikimi OEKO-TEX lekurë	0 - 5 pikë

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Nga verifikimi i DST-ve, Shtojcës nr.1, dokumentit Sqarime nr. 1, si dhe Anekseve të publikuara nga AZHPP, nuk rezulton të jetë publikuar ndonjë informacion, sqarim apo argumentim, lidhur me bazën ligjore ku mbështeten sistemi i pikëzimit.

Gjithashtu, konstatohet se: pavarësisht se sistemi elektronik i shpërndarjes është hequr si artikull për të cilin mund të ofertosh, referuar DST-ve ky artikull është subjekt vlerësimi me pikë.

Gjithashtu, në DST është përcaktuar se:

I. Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi të artikujve të uniformës. *Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).*

Në DST dhe dokumentat e tjera të publikuara nga ABP, nuk është dhënë asnjë sqarim apo argument se përse ka zgjedhur këtë metodë vlerësimi.

Nga ana tjetër, në Dokumentin Sqarime nr. 1 datë 15.10.2019, ABP ka sqaruar se: *“Gjendja e tregut vendas dhe atij të huaj e mundëson pjesëmarrjen në fazën e parë të parakualifikimit, të më shumë se dy operatorëve ekonomik që mund të realizojnë objektin e prokurimit, të cilët mund të marrin pjesë edhe si bashkim operatorësh ekonomik. Mallrat dhe shërbimet në lidhje me to, nuk gjenden lehtësisht në treg dhe kanë specifikime teknike e standarde të vecanta, të cilat janë të miratuara me akt nënligjor”.*

Opinion i ekspertit mbi veprimet e ABP-së për përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së operatorik ekonomik fitues:

Në nenin 55 *“Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”* të Ligjit të Prokurimit Publik parashikohet se:

1. *Oferta fituese duhet të jetë:*

a) *oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose*

b) *oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.*

Në nenin 31 *“Kriteret për vlerësimin e ofertës”* të VKM nr. 914 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët. 2. Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të*

një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin”.

Përzgjedhja e metodës së ofertës ekonomikisht më të favorshme nga e ABP-së për të vlerësuar ofertën fituese, nuk plotëson kriteret e sipërcituara ligjore, pasi, ashtu siç është cituar nga ana e ABP në Dokumentin Sqarime nr. 1, artikujt objekt kontrate pavarësisht se nuk gjenden lehtësisht në treg, rezultojnë të kenë specifikime teknike e standarde të vecanta, të cilat janë të miratuara me akt nënligjor.

Në kushtet kur kërkohet të prokurohen mallra me standarde të përcaktuara, madje të miratuara me akte ligjore e nënligjore, kriteri më i favorshëm dhe më i leverdisshëm për të përcaktuar ofertën fituese do të ishte CMIMI MË I ULËT. Përcaktimi i kësaj metodologjie vlerësimi, potencialisht rrit konkurrencën dhe automatikisht mund të sjellë oferta më të ulta, e për rrjedhojë realizon të paktën 3 nga qëllimet kryesore të LPP-së, siç janë: Mirëpërdorimi i fondeve publik; nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public dhe nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë;

4) VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR HARTIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT, PËRFSHIRË HARTIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT;

Referuar njoftimit të Kontratës, të publikuar në faqen elektronike të prokurimit publik www.app.gov.al, rezultojnë se AZHPP ka publikuar dokumentat standarde të tenderit në datë 26.07.2019.

Së bashku me DST janë publikuar dhe anekset shoqëruese të tyre dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Procedura e prokurimit është: “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” - Prokurim Elektronik, nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjeve kuadër 4 (katër) vite.

Në nenin 34 të VKM nr. 914, parashikohet se procedura e kufizuar është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 31 të LPP-së. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat, në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i sitemit elektronik të prokurimeve rezultojnë se në datë 15.10.2019 AZHPP ka publikuar Shtojcën 1, me anën e së cilës janë kryer mbi 20 ndryshime në DST, si dhe ka publikuar dokumentin Sqarime nr. 1, me anën e të cilit janë dhënë sqarime të ndryshme mbi procedurën e prokurimit.

Nga verifikimi i DST-ve, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe dokumentave të publikuara konstatojmë se:

Në Fazën e I-rë operatorët ekonomikë të interesuar duhet të përmbushin kriteret e kualifikimit si vijon:

Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5, në vlerën prej 56.006.952 Lekë.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

(për tu plotësuar nga kandidatët në Fazën e I - Parakualifikimi)

- a) Kandidati duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në dy vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 10% e vlerës së fondit limit total (vlera e pritshme e kontratave).
- b) Kandidati duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2017, 2018), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

1.3 Kapaciteti

teknik:

(për tu plotësuar nga kandidatët në Fazën e I - Parakualifikimi)

1. Kandidati duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 10% e vlerës së fondit limit total (vlera e pritshme e kontratave). Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, kandidati duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, kandidati duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Kandidati duhet të deklarojë nëse është prodhues i artikujve të uniformës ose tregtues i autorizuar nga prodhuesit e artikujve të uniformës, për këtë objekt prokurimi. Në rast se kandidati nuk është prodhues i artikujve të uniformës, duhet të vërtetohet lidhja midis tij dhe prodhuesit. Dokumenti provues për këtë objekt prokurimi, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: ëbsite, e-mail, telefon, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
3. Kandidati duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e mallrave që kërkohen të prokurohen, sipas përcaktimeve në pikën 4 "Garancitë" të Shtojcës 11 të dokumentave të tenderit.
4. Kandidati duhet të paraqesë deklaratë mbi marrjen përsipër të shpërndarjes së uniformës dhe tek punonjësit e policisë, sipas termave të referencës të përcaktuara në Aneksi nr.9 - i ndryshuar - Sistemi Elektronik i Shpërndarjes.
5. Kandidati duhet të deklarojë numrin e fuqisë punëtore që ka në dispozicion për ekzekutimin e objektit të prokurimit (minimalisht 100 punonjës), ku të përfshihet edhe lista emërore e personelit kryesor teknik për zbatimin e objektit të prokurimit, për të cilët duhet të deklarohet profesioni dhe detyrat që kryejnë, përsa i përket:
 - a) Krijimit, zhvillimit, instalimit, mirëmbajtjes së sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe trajnimit për përdorimin e sistemit, me minimalisht 5 (pesë) persona.
 - b) Prodhimit dhe shpërndarjes së artikujve të uniformës (veshje dhe këpucë), me minimalisht 10 (dhjetë) persona.

Në Fazën e II - të operatorët ekonomikë të interesuar duhet të përmbushin kriteret e kualifikimit si vijon:

A. Oferta Ekonomike duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

- 1) Formularin e Ofertës të plotësuar sipas Shtojcës 3 të dokumentave të tenderit.
- 2) Deklarata për Paraqitje Oferte të Pavarur, sipas Shtojcës 3/1 të dokumentave të tenderit.

B. Oferta Teknike duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore, të realizuara me ente publike, ose fatura tatimore të shitjes, të realizuara me subjekte private, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave për Fazën II, me qëllim peshimin dhe vlerësimin me pikë të kapacitetit teknik në këtë fazë, për furnizime të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe këpucëve të të njëjtës natyrë. Furnizime të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe këpucëve të të njëjtës natyrë, do të konsiderohen: veshje dhe këpucë uniforme policie, ushtarake, garde, forca speciale, marine, etj.*
 2. *Ofertuesi duhet të paraqesë për numrin e deklaruar të fuqisë punëtore, listëpagesat e deklarueshme të konfirmuara nga Administrata Tatimore sipas legjislacionit në fuqi, të 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave teknike.*
 3. *Ofertuesi duhet të deklarojë personelin kryesor teknik për zbatimin e objektit të prokurimit, përsa i përket krijimit, zhvillimit, instalimit, mirëmbajtjes të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe trajnimit për përdorimin e sistemit, si dhe të paraqesë dokumentacionin: CV, librezë pune, kontratë pune dhe diplomë për shkenca kompjuterike, informatike, elektronike ose ekuivalente, për personelin si vijon:*
 - a. *të paktën 1 (një) punonjës DBA të certifikuar në platformën e zgjedhur,*
 - b. *të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për programim në platformën e zgjedhur,*
 - c. *të paktën 1 (një) punonjës për Testim aplikacionesh,*
 - d. *të paktën 1 (një) menaxher të caktuar për projektin, i cili duhet të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë pune në analizë dhe drejtim projektesh të ngjashme.*

Nje individ mund të zotërojë më shumë se një certifikatë nga certifikatat e mësipërme.”
 4. *Ofertuesi duhet të paraqesë për personelin kryesor teknik të deklaruar për zbatimin e objektit të prokurimit, përsa i përket prodhimit dhe shpërndarjes së artikujve të uniformës (veshje dhe këpucë), dokumentat: CV, diploma apo dëshmi të aftësive profesionale (nëse i zotërojnë), për :*
 - *inxhinier tekstili, të paktën 1(një) punonjës*
 - *kimist, të paktën 1(një) punonjës*
 - *modelist për veshje, të paktën 1(një) punonjës*
 - *modelist për këpucë, të paktën 1(një) punonjës*
 - *përgjegjës prodhimi veshje, të paktën 1(një) punonjës*
 - *përgjegjës prodhimi këpucë, të paktën 1(një) punonjës*
 - *kontrollor cilësie veshje, të paktën 1(një) punonjës*
 - *kontrollor cilësie këpucë, të paktën 1(një) punonjës*
 - *specialist të lëkurës dhe këpucëve, të paktën 1(një) punonjës*
 - *menaxher shpërndarje, të paktën 1(një) punonjës*
 5. *Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 22301 (të vlefshme) për sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit, në fushën e objektit të prokurimit.*
 6. *Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 27001 (të vlefshme) për menaxhimin e sigurisë së informacionit.*
- Çertifikatat të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
7. *Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet dhe certifikatë LEATHER by OEKO-TEX për lëkurën (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX, pranohen raportet e testimin nga laboratorë të akredituar, të cilët vërtetojnë se lëndët e para*

nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX.

8. Çertifikata konformiteti për çdo model këpuce (aty ku kërkohet), sipas:

- EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347- 2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347- 2012 O2 HRO HI WR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 të modelit B - O2 CI WR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 të modelit A - O2 WR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 O2 WR FO SRC ose ekuivalentet.

Pranohet edhe mundësia e paraqitjes së standardeve SSH/EN mbi konformitetin e standardeve europiane.

Çertifikatat të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat e konformitetit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar, të pavarur nga prodhuesi i lëndës së parë dhe produktit të gatshëm. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.

9. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Skedat teknike të tekstilit, lëkurës, shollës, astarit të këpucëve, përforcueses së shollës, plastikës, metalit të përdorur për prodhimin e artikullit, e lëshuar nga prodhuesi i tij dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese përkatëse.
- b) Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar, të pavarur nga prodhuesi i lëndës së parë dhe produktit të gatshëm. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
- c) Deklaratë nga prodhuesi i aksesorëve për përbërjen e materialeve të përdorura dhe cilësinë e tyre, sipas Specifikimeve Teknike, e konkretisht për: kopsat metalike (të mëdha, të vogla, xhemel), rripi i zi i kapelës, stema metalike dhe ornamentet e jakës, stema plastike, togëza metalike për rripat, kordona dekorativë për uniformën ceremoniale.
- d) Skeda teknike të produktit të gatshëm (për gradat, shenjat, stemat) e lëshuar nga prodhuesi sipas provave laboratorike të përcaktuara në Specifikime Teknike.

Mosdorëzimi i dokumentacionit shoqërues të mostrave / kampioneve, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 11 dhe 12 të këtij seksioni, përbën kusht për skualifikim.

Ofertuesi duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat / kampionet e disa prej artikujve që kërkohen të prokurohen

Nga sa mësipër, rezulton :

*ABP ka përcaktuar që: të paktën një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të parashikuara për t'u vlerësuar në Fazën e I-rë dhe konkretisht Kriteri për eksperiencën të ngjashme i cili vlerësohet me sistemin kualifikohet/skualifikohet, është kërkuar edhe në Fazën e II-të, madje i njëjti kriter që në Fazën I vlerësohet me sistemin kualifikim/skualifikim, në fazën II parashikohet të vlerësohet me sistemin e vlerësimit me pikë.

*ABP ka përcaktuar që në Fazën e I-rë të dorëzohet Sigurimi i ofertës, ndërkohë që oferta ekonomike parashikohet të dorëzohet në Fazën e II-të.

*ABP ka kërkuar si kriter të veçantë Kualifikimi të detyrueshëm për t'u përmbushur nga OE pjesëmarrës në garë: “numrin e fuqisë punëtore – minimalisht 100 punonjës”, ndërkohë që objekti i procedurës është Prokurimi i Mallrave.

*ABP ka përcaktuar detyrimin për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, plotësimin e specifikimeve teknike madje edhe vlerësimin me pikë të artikullit “*sistemi elektronik i shpërndarjes së uniformave dhe këpucëve*”, ndërkohë që referuar Shtojcës 1 të publikuar nga ABP rezulton se ky artikull do të ofrohet “pa shpërblim” nga OE pjesëmarrës në garë.

*Në ndryshimet e publikuara në Shtojcën nr. 1, rezulton se nga njëra anë është hequr detyrimi për të ofertuar për sistemin elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve, ndërsa nga ana tjetër kanë qëndruar në kriteret e veçanta të kualifikimit, detyrimet e OE për të vërtetuar se disponojnë eksperiencë apo kualifikime të nevojshme për sistemin elektronik të shpërndarjes, si dhe specifikimet teknike për këtë sistem.

Për më tepër, në Shtojcën 1 të publikuar nga APB në datë 15.10.2019 parashikohet në mënyrë eksplicite se: “Organi qendror blerës ka përcaktuar si arsye skualifikimi të ofertuesve në fazën e dytë, rastin e mosqendrimit të manualit të përdorimit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe të linkut ku mund të aksesohet një demo e sistemit në internet së bashku me kredencialet e nevojshme (username dhe password), pasi mosplotësimi i këtij kriteri rrjedhimisht con në mosrealizimin e kontratës sic është kërkuar nga autoriteti kontraktor, përsa i përket porositjes dhe shpërndarjes së artikujve, të përcaktuara në specifikimet teknike dhe termat e referencës”.

Pra, praktikisht operatorët ekonomikë janë detyruar të plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit dhe përmbushin specifikimet teknike madje edhe të skualifikohen apo marrin më pak pikë, për një mall - sistemin elektronik, të cilin duhet ta ofrojnë “pa shpërblim” për ABP-në.

Opinionit i ekspertit mbi veprimet e ABP-së për hartimin e dokumentave standarde të tenderit, përfshirë hartimin e termave të referencës dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit:

Në nenin 27 të VKM nr. 914 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

Ndërsa në nenin 46 të LPP parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*”.

Bazuar në kuadrin ligjor të sipërcituar, referuar DST-ve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të publikuara nga ABP, si dhe mbështetur në konstatimet e mësipërme, vlerësoj se përcaktimi i kriterëve të kualifikimit nuk është kryer në harmoni me parashikimet ligjore dhe të Rregullave të Prokurimit Publik. Kriteret e kualifikimit nuk janë hartuar në përputhje me llojin dhe në përpjesëtim me natyrën e kontratës, si dhe nuk janë në përputhje dhe në koherencë me procedurën e përzgjedhur për t’u zhvilluar. Për rrjedhojë, ato mund të çenojnë qëllimin e LPP dhe ndikojnë drejtpëdrejt në: a) nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

5) ANALIZË MBI VEPRIMET E AUTORITETIT TË NGARKUAR PËR TË ZHVILLUAR PROCEDURËN E PROKURIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTUESVE QË KANË SHPREHUR INTERES PËR TË MARRË PJESË NË

GARË, KUALIFIKIMIN E TYRE DHE DËRGIMIN E FTESËS PËR TË PARAQITUR OFERTË;

Nga shqyrtimi i sistemit elektronik të prokurimeve konstatojmë se:

Në datë 24.02.2020 AZHPP ka realizuar vlerësimin e OE që kanë shprehur interes për pjesëmarrje në Procedurën e Prokurimit dhe ka vendosur të dërgojë ftesë për paraqitjen e ofertës teknike dhe ekonomike për shoqëritë si vijon:

1. “Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti” – Shoqëri me seli në Turqi;
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë: ”D&E SHPK” + “SUMMER CONF. s.r.l” + “LOVERS s.r.l” + “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU” –Përfaqësuesi i BOE - ”D&E SHPK”: me seli në Tiranë - Shqipëri;
3. Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: ”KAP-KO d.o.o” + “ODJECA d.o.o” + “GALKO d.o.o” + “JELEN PROFESSIONAL d.o.o” + “GALEB d.d” + “OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK”, Përfaqësuesi i BOE - ”KAPKO d.o.o”, me seli në Zagreb, Kroatia;

Nga shqyrtimi i dokumentave të publikuara në sistemin elektronik, si dhe nga shqyrtimi i Buletineve të Njoftimeve Publike në faqen elektronike www.app.gov.al, vërejmë se nuk ka informacion lidhur me të dhënat (emrat, selinë apo përfaqësuesit) e OE që kanë shprehur interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, si dhe nëse ka OE të skualifikuar me arsye konkrete.

OE e kualifikuar nga ABP janë ftuar të paraqesin ofertat ekonomike në datë 10.04.2020.

Opinionin i ekspertit mbi vendimarrjen e Autoritetit Kontraktor:

Në kushtet e publikimit të informacionit të kufizuar nga ana e ABP-së, lidhur me vendimarrjen e Fazës së I-rë konstatoj se:

***Përgjithësisht numri i OE që janë kualifikuar në Fazën I-rë është i kufizuar, vetëm 3 OE mundën të kualifikoheshin;**

***Nga 3 OE të vlerësuar pozitivisht në Fazën e I-rë, dy prej tyre janë bashkime shoqërisht dhe vetëm një OE ka ofertuar si i vetëm**

***Nga 3 OE të vlerësuar pozitivisht në Fazën e I-rë, kryesisht dy OE janë të Huaj (një OE është 100% ndërsa OE tjetër ka një anëtar local), ndërsa vetëm përfaqësuesi i njërit prej 3 OE të kualifikuar është shoqëri e regjistruar në Shqipëri.**

6) KRONOLOGJIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT ZHVILLUES TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT:

1) Në datë 26.07.2019 është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve Procedura e Prokurimit me objekt “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”;

2) Procedura e përzgjedhur është “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” - Prokurim Elektronik, nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjeve kuadër 4 (katër) vite dhe prokurohet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për Ilogari të Autoritetit Kontraktor DPPSH;

3) Fondi limit: 2.800.347.570 Lekë (pa TVSH) me shumatore të çmimeve për njësi: 21.982.366 Lekë (pa TVSH), ku përfshihet: a) Shumatorja e çmimeve për njësi të artikujve të veshjeve dhe këpucëve: 488.141 Lekë (pa TVSH) dhe b) Shumatorja e çmimeve për njësi të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve: 21.494.225 Lekë (pa TVSH).

- 4) Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është caktuar data 19.08.2019, ora 10:00; në www.app.gov.al .
- 5) Në datë 15.10.2019 AZHPP me Shtojcën 1 ka modifikuar dok e tenderit, përfshirë kriteret e kualifikimit dhe çmimin/njësi të artikujve objekt kontrate;
- 6) Po në datën 15.10.2019 AZHPP ka publikuar dok Sqarime nr. 1 me anën e të cilit ka publikuar disa sqarime për OE të interesuar;
- 7) Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është shtyrë për në datën 05.11.2019, ora 10.00 në www.app.gov.al ;
- 8) Në datë 22.10.2019 OE “Marsi & AL” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë AK me objekt: modifikimin e DST. Ankesa është refuzuar nga AK;
- 9) Në datë 01.11.2019 OE “Marsi & AL” sh.p.k., ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit;
- 10) Me vendimin nr. 790/2019 datë 19.12.2019, KPP e ka refuzuar ankesën e paraqitur nga ky OE;
- 11) Me njoftimin e datës 24.12.2019, ABP ka njoftuar në sistemin elektronik se Faza e I-rë e Procedurës së Prokurimit - dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrje është shtyrë për në datë 10.01.2020.
- 12) Në datë 10.01.2020 është hapur Faza e I-rë e Procedurës – kërkesat për shprehje interesi;
- 13) Në datë 24.02.2020 ABP përfundoi vlerësimin e Fazës së I-rë dhe vendosi të kualifikojë për Fazën II-të OE: **1.** “Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti”; **2.** BOE ”D&E SHPK” + “SUMMER CONF. s.r.l” + “LOVERS s.r.l” + “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU”; 3. BOE ”KAP-KO d.o.o” + “ODJECA d.o.o” + “GALKO d.o.o” + “JELEN PROFESSIONAL d.o.o” + “GALEB d.d” + “OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK”.
- 14) Po në datë 24.02.2020 ABP u dërgoi ftesë 3 shoqërive të sipërcituara për të paraqitur një ofertë ekonomike. Data e paraqitjes së ofertës u caktua: 10.04.2020 ora 11.00

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE TË RASTIT STUDIMOR

Në përfundim të hulumtimit përmes këtij rasti studimor, konstatohet se:

1) REFERUAR NUMRIT SHUMË TË MADH TË NDRYSHIMEVE (PËRFSHIRË EDHE ÇMIMIN/NJËSI) ARRIJMË NË PËRFUNDIMIN SE AGJENCIA E BLERJEVE TË PERQENDRUARA NUK KA PATUR INFORMACIONIN DHE NJOHURITË E NEVOJSHME PËR TË REALIZUAR KËTË PROCEDURË TË KËSAJ NATYRE DHE KËTYRE PËRMASAVE;

2) SHPALLJA E PROCEDURËS ME NJË LOT TË VETËM, DUKE PËRFSHIRË SË BASHKU ME VESHJET DHE KËPUCËT EDHE SISTEMIN ELEKTRONIK TË SHPËRNDARJES, KA ÇUAR NË NJË KUFIZIM TË PJESËMARRJES NË GARË, DUKE DISKRIMINUAR OPERATORËT LOKALË, SI DHE DUKE DETYRUAR QË OE TË GRUPOHEN NË BOE;

3) PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS SË KUFIZUAR NGA AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA, NUK MBËSHTETET NË PËRCAKTIMET E LIGJIT DHE RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK;

4) PËRCAKTIMI I METODËS SË OFERTËS EKONOMIKISHT MË TË FAVORSHME, PËR TË ZGJEDHUR FITUESIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, NUK ËSHTË

KRYER NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E LIGJIT DHE RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK;

5) KRITERET E KUALIFIKIMIT, NUK JANË HARTUAR NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR, SI DHE NUK JANË NË PËRPUTHJE ME LLOJIN, NATYRËN DHE PËRMASAT E KONTRATËS;

Burimet e përdorura nga Ekspertët për marrjen e informacionit për hartimin e këtij Rasti Studimor janë:

Faqja elektronike e prokurimeve www.app.gov.al ;

Faqja elektronike e Komisionit të Prokurimit Publik www.kpp.gov.al ;

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;

VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar;

Njoftimi i Kontratës, datë 26.07.2019, i publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

DST të publikuara nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

DST të ndryshuara, të publikuara nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Shtojca nr. 1, datë 15.10.2019, e publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Dokumenti Sqarime nr. 1, datë 15.10.2019, i publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Njoftim datë 24.12.2019, i publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al

Ftesë për ofertë për OE “Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti”, datë 24.02.2019, e publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Ftesë për ofertë për BOE “D&E SHPK” + “SUMMER CONF. s.r.l” + “LOVERS s.r.l” + “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU”, datë 24.02.2019, e publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Ftesë për ofertë për BOE “KAP-KO d.o.o” + “ODJECA d.o.o” + “GALKO d.o.o” + “JELEN PROFESSIONAL d.o.o” + “GALEB d.d” + “OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK”, datë 24.02.2019, e publikuar nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;

Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Termat e Referencës, specififikimet teknike dhe Anekset e publikuara nga ABP në sistemin elektronik të prokurimeve www.app.gov.al ;